

VENDIM
Nr. 39, datë 23.9.2016

PËR LICENCIM SHA UJËSJELLËS KURBIN

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Rinovim licence operatorit sh.a. Ujësjiellës Kurbin, me:
Drejtues ligjor: Alfred Prodani
Drejtues teknik: Julinda Elezi
2. Operatori sh.a. Ujësjiellës Kurbin autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Kurbin.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).
Shfuqizohet vendimi nr. 21, datë 14.11.2014 “Rinovim licence sh.a. Ujësjiellës Kurbin”.

KRYETARI
Ndriçim Shani